

VENDIM
Nr. 265, datë 26.3.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTEVE “RIVITALIZIMI I QENDRËSË QYTETIT TË LUSHNJËS” DHE “RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS ROTONDO PLUKUT-POSTBLLOKU, RRUGA E HYRJES LUSHNJË-TIRANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve “Rivitalizimi i qendrës së qytetit të Lushnjës” dhe “Rikonstruksioni i rrugës Rotondo Plukut-Postblloku, rruga e hyrjes Lushnjë-Tiranë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 13 011 927 (trembëdhjetë milionë e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e shtatë) lekësh, dhe për pasuritë “ndërtesa”, me vlerë të përgjithshme 33 607 972.91 (tridhjetë e tre milionë e gjashtëqind e shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy pikë nëntëdhjetë e një) lekë.

4. Vlera totale e shpronësimit, prej 46 619 899.91 (dyzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e një) lekësh, të përballohet nga fondi i shpronësimeve, në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë në datën 30.3.2015.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP” dhe “Plotësim doku-mentacioni”, të kompensohen, për efekt shpronë-simi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkë-punim me Bashkinë Lushnjë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar nga Bashkia Lushnjë dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë dhe Bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Rivitalizimi i Qendrës së Qytetit të Lushnjës

Rotondo Plukut-Postblloku, rruga hyrjes Lushnjë-Tiranë

Pronari	Zona kadastrale	Nr. Pasurisë	Sipërfaqja		Çmimi		Vlera			Vlera Totale (Lekë)	Shënimet (konfirmuar ose jo nga ZVRPP, et.)
			Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim	Banese	TOTALI	
1 Gazmend Korreshi	8571	169/5	171	113.9	7517	38500	1285407	994037.55	2295840	4,575,284.55	Vërtetim Hipotekor
2 Bashkim Takaku	8571	169/7	0	128	7517			2985003.39		2,985,003.39	Vërtetim Hipotekor
3 Besnik Qokaj	8571	169/6	57.2	57.2	7517		429972.4	817509.56		1,247,481.96	Vërtetim Hipotekor
4 Vladimir, Amarildo Dyrmishi	8571	169/4	500	125	7517		3758500	4921533.72		8,680,033.72	Vërtetim Hipotekor
							Shuma Totale (Lekë)			46,619,899.91	